Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Majlinda Bedrolli	**11.12.2023**	**15.12.2023**	**2023/0993**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 08.12.2023, OE "ARITECH"- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0993, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Botek" SH.P.K- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me pajisje te Teknologjise Informative" me nr. të prokurimit: "615-23-4097-5-5-8", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PODUJEVËS.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontrat?s: xx,xxx €. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

AK ka shkelur gjatë realizimit të kësaj procedure ka shkelur dispozitat e LPP-së si më poshtë:

Neni 7
Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

3/7

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Ne me date 23.11.2023 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.
Ne njoftimin mbi vendimin AK ka vendosur te shperbleje me kontrate OE Botek Shpk.
Ne vijim do te paraqesim nje kronologji te tenderit ne fjale:
Autoriteti Kontraktues ka zhvilluar procedure permes minitendereve duke derguar **ftese per oferte me date 26.04.2023** per kontraten kornize e cila eshte realizuar ne kuader te AQP-se.
Dorezimi i ofertes ka qene me date 06.06.2023, ne kete aktivitet kane marr pjese gjithesej 5 ofertues.
Perveç kerkesave tjera ne dosje te tenderit eshte kerkuar qe validiteti i tenderit te jete 60 dite kalendarike, poashtu eshte kerkuar qe sigurimi i tenderit ne vlere 6000 euro per nje periudhe te vlefeshmerise te jete 60 dite.
Autoriteti kontraktues gjate kesaj periudhe 60 diteshe nuk ka bere asnje veprim, por jo vetem brenda kesaj periudhe por edhe per 80 dite te tjera nuk ka pas ndonje veprim.
AK me Veprim (mosveprim) te tille i vendos ne pozite te pabarabarte operatoret ekonomik.
Duke analizuar oferten e OE Botek shpk kemi hasur ne dokumente me te cilat eshte vazhduar validiteti i ofertes dhe sigurimit te tenderit.

Shih printscreen 1

BOTEK
IT ▪ Communication ▪ Security

Prishtinë, 10 Gusht 2023

Autoriteti kontraktues: Komuna e Podujevës
Titulli i tenderit: Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative

Numri i Prokurimit: 615-23-4097-5-5-8

Konfirmim për vazhdim të validitetit të ofertës

Bazuar në RrPP, neni 30, pika 30.4 – AK duhet të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. (Është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit).
Ne, si OE, nuk kemi pranuar nga AK kërkesën për vazhdimin e validitetit, mirëpo në mënyrë që të kemi ofertën tonë valide, duke synuar që të jemi në harmoni me dispozitat ligjore, ne në mënyrë vullnetare deklarojmë:
Përmes kësaj shkrese konfirmojmë vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës sonë edhe për 60 ditë kalendarike, nga data e skadimit të vlefshmërisë së ofertës (05.08.2023) për tenderin me titull: **Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative** dhe me numër të prokurimit: **615-23-4097-5-5-8.**

Oferta jonë do të jetë e vlefshme deri me datë: **04.10.2023.**

Gjithashtu konfirmojmë edhe vazhdimin e sigurimit të tenderit, nga data e skadimit (05.08.2023) edhe për 60 ditë kalendarike. Sigurimi i tenderit do të jetë i vlefshëm deri më 04.10.2023.

Printscreen 2

BOTEK
IT ▪ Communication ▪ Security

Prishtinë, 5 Tetor 2023

Autoriteti kontraktues: Komuna e Podujevës
Titulli i tenderit: Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative

Numri i Prokurimit: 615-23-4097-5-5-8

Konfirmim për vazhdim të validitetit të ofertës

Bazuar në RrPP, neni 30, pika 30.4 – AK duhet të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. (Është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit).
Ne, si OE, nuk kemi pranuar nga AK kërkesën për vazhdimin e validitetit, mirëpo në mënyrë që të kemi ofertën tonë valide, duke synuar që të jemi në harmoni me dispozitat ligjore, ne në mënyrë vullnetare deklarojmë:
Përmes kësaj shkrese konfirmojmë vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës sonë edhe për 60 ditë kalendarike, nga data e skadimit të vlefshmërisë së ofertës (04.10.2023) për tenderin me titull: **Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative** dhe me numër të prokurimit: **615-23-4097-5-5-8.**

Oferta jonë do të jetë e vlefshme deri me datë: **04.12.2023.**

Gjithashtu konfirmojmë edhe vazhdimin e sigurimit të tenderit, nga data e skadimit (04.10.2023) edhe për 60 ditë kalendarike. Sigurimi i tenderit do të jetë i vlefshëm deri më 04.12.2023.

Printscreen 3

BOTEK
IT ▪ Communication ▪ Security

Prishtinë, 25 Tetor 2023

Autoriteti kontraktues: Komuna e Podujevës
Titulli i tenderit: Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative

Numri i Prokurimit: 615-23-4097-5-5-8

Konfirmim për vazhdim të validitetit të ofertës

Përmes kësaj shkrese konfirmojmë vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës sonë edhe për 30 ditë kalendarike, nga data e skadimit të vlefshmërisë së ofertës (04.12.2023) për tenderin me titull: **Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative** dhe me numër të prokurimit: **615-23-4097-5-5-8**.

Oferta jonë do të jetë e vlefshme deri me datë: **03.01.2024.**

Siç shihet me lart Botek shpk ka derguar vazhdimin e validitetit dhe sigurimit te tenderit me datat e lartecekura.
Pra nga keto verehet qarte qe AK ne kordinim me OE Botek ka pranuar zgjatje te validitetit te ofertes vetem nga ky OE , pa kerkuar nje gje te tille nga OE-te e tjere pjesmarres ne kete aktivitet se paku jo nga Aritech Shpk Per me teper ky veprim i AK-se ka bere qe se paku OE Aritech Shpk (por jo vetem) te kete oferta te pavlefshme (pa mbuluara me sigurim dhe vlefshmeri)
dhe per te arsyetuar veprimin me date 25.10.2023 permes e-mailit kerkon zgjatjen e validitetit te tenderit dhe sigurimit te tenderit.

Printscreen nga E-mail, i derguar nga AK- Komuna e Podujevës

From: prokurimi podujeva <prokurimi.podujeva@rks-gov.net>
Sent: Wednesday, October 25, 2023 2:35 PM
To: diti@ilir-ks.com; edona@interadria-ks.com; arbnora@aritech-ks.com; zymber.zuzaku@storm-ict.com; hilmi.asllani@bo-tek.com; leonida.ternava@bo-tek.com; office@bo-tek.com
Subject: Kërkesë për zgjatjen e afatit te vlefshmërise dhe sigurise së tenderit

Të nderuar,

Ju jeni pjesëmarrës në tenderin me nr 615234097558

Kjo procedurë ka ngec deri më tani në mungesë të mjeteve buxhetore.

Tani AK ka siguruar mjetet dhe ne mund të vazhdojmë me publikimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK

Para se të bëhet ky Njoftim, ju lutemi që te na ofroni nje deklarate per zgjatjen e vlefshmerise se tenderit si dhe ta beni vazhdimin e siguris se tenderit

Vlefshmeria e tenderit te zgjatet per 60 dite ndersa siguria e tenderit per 30 dite

Dokumentet të sillen jo me larg se deri me date 27.10.2023

Ne rast te deshtimit te dokumentacionit deri ne afatin e caktuar, ne konsiderojme se ju keni heq dore nga ky projekt.

Me respekt!

Zyra e prokurimit, Podujeve

Pra nga ky veprim lind pyetja :

-

Pse OE Botek ne menyre te njeanshme ka zgjatur validitetin?

-

Nese kete e ka bere pa i kerkuar AK pra "pa kordinim me AK", pse AK nuk ka kerkuar zgjatjen e validitetit edhe per ofertat e tjera por nje gje te tille e ka bere me nje vonese prej 80 dite nga dita e skadimit te vlefshmeris te te gjitha ofertave te OE-te tjere? –

A ndodh qe AK ka kerkuar zgjatjen e validitetit vetem nga OE Botek (permes tel, e-mail) dhe jo per te tjeret?

Pra edhe nje here po potencojme qe AK s'ka bere asnje veprim (kerkese) ne e-prokurim, asnje kerkese drejtuar nga AK permes e-mail deri me date 25.10.2023.

Me te pranuar kerkesen ne si operator ekonomik ne pergjigje kemi sqaruar si ne vijim:

Pergjigja me e-mail ne vijim"

Pershendetje,

Lidhur me kerkesen tuaj, ju perkujtojme qe nuk mund te kerkohet zgjatja e validitetit dhe sigurimit te tenderit ne menyre retroactive.

Mund te shihni me poshte sqarimin nga KRPP:

7. 22.11.2022 Periudha e validitetit të ofertës ka skaduar derisa lënda ka qenë në shqyrtim në OSHP dhe aktiviteti i prokurimit ka qenë në pezullim. A mund të nënshkruhet një kontratë publike pa validitet të ofertës?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, KRPP ofron interpretimin ligjor si në vijim: Neni 30.3 i Rregullores për Prokurimin Publik, përcakton: "30.3 Periudha e validitetit të tenderit e specifikuar në dosjen e tenderit do të ndryshoj varësisht nga kompleksiteti i prokurimit. periudha e kërkuar e validitetit do të jetë jo më shumë se që është e nevojshme, dhe do të jetë e mjaftueshme për AK të bëjë vlerësimin e tenderëve të pranuar dhe të bëjë dhënien dhe nënshkrimin e kontratës". Neni 30.4 i Rregullores për Prokurimin Publik, përcakton: "30.4 Në situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetin të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit dhe duhet të ngritet në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)" "30.5 Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët do të kërkohet që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre". Sipas nenit 30.4 të lartcekur, nuk përcaktohet sa ditë para skadimit të validitetit të ofertave mund të kërkohet zgjatja e afatit të validitetit të ofertave. Megjithatë, është e rëndësishme që të ketë kontinuitet midis afatit të skaduar dhe atij të ri, për këtë arsye në këtë dispozitë thuhet: "para datës së skadimit...." Pavarësisht se aktiviteti i prokurimit është në "Pezullim", AK në përputhje me nenin 30.4 të Rregullores për Prokurimin Publik duhet që të kërkojë zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Asnjë dispozitë e LPP-së dhe e legjislacionit dytësor, nuk përcakton përkufizimin e fjalës "Pezullim", megjithatë, KRPP konsideron se fjala "Pezullim" në kuptim të këtij ligji duhet të nënkuptojë mosndërmarrjen e ndonjë hapi në procedurat e prokurimit për derisa aktiviteti i prokurimit është i pezulluar. (Psh: hapja e tenderëve nuk duhet të bëhet nëse aktiviteti i prokurimit është pezulluar si rezultat i Kërkesës për rishqyrtim e parashtruar në AK, apo e një ankese e parashtruar në OSHP gjatë fazës së tenderimit, apo nënshkrimi i kontratës nuk duhet të bëhet për deri sa aktiviteti i prokurimit është në pezullim si rezultat i parashtrimit të një kërkese për rishqyrtim në AK, apo një ankese në OSHP) Neni 30.3 i Rregullores për Prokurimin Publik, kërkon rreptësishtë që oferta të ketë validitet deri te dhënia dhe nënshkrimi i kontratës. **Prandaj KRPP konsideron se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës. Për këtë arsye, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duhet me kujdesin më të madh të përcjellë validitetin e ofertave, dhe në çdo rast duhet të kërkojë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohet zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit. KRPP do të monitorojë me kujdes të veçantë autoritetet kontraktuese për moszbatimin e nenit 30.4 të Rregullores për Prokurimin Publik. Mos zbatimi i nenit 30.4 klasifikohet si shkelje e rëndë sipas nenit 97 të kësaj rregulloreje, andaj KRPP do të ndërmarr masa në përputhje me nenin 97 të Rregullores për Prokurimin Publik.**

AK me date 30.11.2023 e Refuzon kerkesen per Rishqyrtim si te pabazuar.
Ne sqarimet e saj thote qe OE Botek shpk e zgjate validitetin e ofertes dhe te sigurimi te tenderit ne menyre vullnetare.
AK poashtu konfirmon qe me date 25.10.2023 ka kerkuar zgjatjen e validitetit dhe sigurimit.
Kerkesa e tille per zgjatje te validitetit dhe sigurimit eshte retroaktive (E pamundur nga OE te dergohet zgjatja e validitetit dhe sigurimit ne menyre retroaktive.

Vazhdimi prej asaj date (25.10.2023) eshte i pavlefshem sepse nuk mbulohet nga data e skadimit te validitetit dhe sigurimit te tenderit.
AK nese do te kishte interesim per te proceduar me kete aktivitetet te prokurimit do duhej te zbatonte Nenin 30.4 te rregullores per prokurim publik.
Kerkojme nga Organi Shqyrtues i prokurimit te marre masa ndaj Zyrtarit te prokurimit per moszbatim te Nenit 30.4 siç klasifikohet si shkelje e rende sipas nenit 97 te rregullores per prokurim publik.

Lidhur me pergjigjen e AK-se, ne e kundershtojme me sqarimin e KRPP-se:

Citojme:
Prandaj KRPP konsideron se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës. Për këtë arsye, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duhet me kujdesin më të madh të përcjellë validitetin e ofertave, dhe në çdo rast duhet të kërkojë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohet zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit. KRPP do të monitorojë me kujdes të veçantë autoritetet kontraktuese për moszbatimin e nenit 30.4 të Rregullores për Prokurimin Publik. Mos zbatimi i nenit 30.4 klasifikohet si shkelje e rëndë sipas nenit 97 të kësaj rregulloreje, andaj KRPP do të ndërmarr masa në përputhje me nenin 97 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Rregullorja eshte e qarte, nuk i eshte lene OE-ve ne menyre vullnetare te zgjasin apo jo validitetin dhe sigurimin e tenderit.

Kjo nuk eshte bere nga Autoriteti kontraktues, prandaj konsiderojme qe ky aktivitet i prokurimit duhet te anulohet.

Duke u bazuar ne argumentet me larte kerkojme nga Organi juaj shqyrtues qe te merr vendim si ne vijim:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar Ankesa e OE "ARITECH SHPK" lidhur me tenderin "**Furnizim me paisje te teknologjis informative**" me nr. prokurimi **615234090558.**

ANULOHET Njoftimi mbi vendimin e AK-se nga "**KOMUNA E PODUJEVËS**", pershkak te mos ndjekjes se procedurave te percakuara sipas LPP-se.
AK-së, të i kërkohet që te veproje sipas LPP-se dhe udhezimeve te qarta ne RRUOP.
Lidhur me mosveprim sipas rregullores, mosveprim sipas sqarimeve nga KRPP dhe LPP-se , te merren masa ndaj Zyrtarit te prokurimit, pasiqe mosveprimi sipas rregullores paraqet shkelje te rende sipas RRUOP nga ana e Autoritetit Kontraktues.

KRITERET PËR VLERËSIM

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES[1]

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: Furnizim me paisje të teknologjisë informative

Nr.i prokurimit	**615**	**23**	**4**	**0**	**9**	**7**	**5**	**5**	**8**
Nr. i brendshem i Prokurimit:									

Nr.		
1.	**GOE:Ilir Kosova shpk Comtrade Computers O.K Prishtinë**	**177 499,00€**
2.	**Inter Adria L.L.C-Prishtinë**	**187 250,00€**
3.	**Aritech-Prishtinë**	**177 761,50€**
4.	**Botek shpk-Prishtinë**	**171 010,00€**
5.	**Storm ICT L.L.C -Prishtinë**	**197 400,00€**
6		
7.		
8.		
9.		
10.		

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Komuna e Podujevës shpërblen me kontratë **OE: Botek shpk -Prishtinë**
- në vlerë totale të kontratës **171 010,00€**

Emri dhe mbiemri i ZP:
Valmira Pollomi

Data:23.11.2023

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **ARITECH**

Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës, përkatësisht kundër Njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të dt. 23.11.2023, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "Botek" Sh.p.k. - Prishtinë. Autoriteti kontraktues ka zhvilluar procedurë përmes mini tenderëve duke dërguar ftesë për ofertë me datë 26.04.2023, për kontratë kornizë, e cila është realizuar në kuadër të AQP-së, dorëzimi i ofertave ka qenë me datë 06.06.2023, ku kanë marrë pjesë gjithsej 5 ofertues. Përveç kërkesave tjera të dosjes së tenderit është kërkuar që validiteti i tenderit të jetë 60 ditë kalendarike. Po ashtu është kërkuar që edhe sigurimi i tenderit në vlerë 6000 euro për një periudhë të vlefshmërisë të jetë 60 ditë. AK gjatë kësaj periudhe 60 ditëshe nuk ka bërë asnjë veprim por jo vete brenda kësaj periudhe por edhe për 80 ditë të tjera nuk ka pas ndonjë veprim. AK me mos veprim të tillë i vendos në pozitë të pabarabartë operatorët ekonomik.

Operatori ekonomik ankues "Aritech" sh.p.k, potencon se ka hasur në dokumente me të cilat operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë "Botek" Sh.p.k, - Prishtinë ka vazhduar validitetin e ofertës dhe sigurimin e tenderit. Ku ka bashkangjitur si prova në ankesë vazhdimin e validitetit dhe sigurimit të tenderit nga OE "Botek" Sh.p.k. - Prishtinë.

Operatori ekonomik ankues "Aritech" sh.p.k, pretendon se autoriteti kontraktues në koordinim me operatorin ekonomik "Botek" Sh.p.k, ka dërguar vazhdimin e validitetit dhe sigurimit të tenderit, ku AK ka pranuar zgjatje të validitetitetit të ofertës vetëm nga operatori ekonomik "Botek" Sh.p.k. Ky veprim i AK-së ka bërë që së paku ne si operator ekonomik (por jo vetëm) të këtë ofertë të pavlefshme (pa mbuluar me sigurim dhe vlefshmëri), ndërsa AK për ti arsyetuar veprimet, me datën 25.10.2023 përmes e-malit kërkon zgjatjen e validitetit të tenderit dhe sigurimit të tenderit.

Ne e-malin e dërguar nga AK-Komuna e Podujevës të datës 25.10.2023 potencohet:

From: prokurimi podujeva <prokurimi.podujeva@rks-gov.net>
Sent: Wednesday, October 25, 2023 2:35 PM
To: diti@ilir-ks.com; edona@interadria-ks.com; arbnora@aritech-ks.com; zymber.zuzaku@storm-ict.com; hilmi.asllani@bo-tek.com; leonida.ternava@bo-tek.com; office@bo-tek.com
Subject: Kërkesë për zgjatjen e afatit te vlefshmërise dhe sigurise së tenderit

Të nderuar,

Ju jeni pjesëmarrës në tenderin me nr 615234097558

Kjo procedurë ka ngec deri më tani në mungesë të mjeteve buxhetore.

Tani AK ka siguruar mjetet dhe ne mund të vazhdojmë me publikimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK

Para se të bëhet ky Njoftim, ju lutemi që te na ofroni nje deklarate per zgjatjen e vlefshmerise se tenderit si dhe ta beni vazhdimin e siguris se tenderit

Vlefshmeria e tenderit te zgjatet per 60 dite ndersa siguria e tenderit per 30 dite

Dokumentet të sillen jo me larg se deri me date 27.10.2023

Ne rast te deshtimit te dokumentacionit deri ne afatin e caktuar, ne konsiderojme se ju keni heq dore nga ky projekt.

Me respekt!

Zyra e prokurimit, Podujeve

Më tej, OE ankues thekson se me të pranuar këtë kërkesë, ne si operator ekonomik kemi sqaruar si në vijim: Lidhur me kërkesën tuaj ju përkujtojmë **që nuk mund** të kërkoni zgjatjen e validitetit dhe sigurimin të tenderit në mënyrë retroaktive, ku kanë bashkangjitur interpretimin nga KRPP me nr.7.22.11.2022, në të cilin thuhet se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës e pa mundur nga OE-të të dërgohet zgjatja e validitetit dhe sigurimit në mënyrë retroaktive. Tutje, OE ankues potencon se vazhdimi prej asaj date (25.10.2023) është i pa vlefshëm sepse nuk mbulohet nga data e sakdimit të validitetit dhe sigurimit të tenderit. AK nëse do kishte interesim për të proceduar me këtë aktivitet të prokurimit do duhet ta zbatonte nenin 30.4 të Rregullores për Prokurim Publik. OE ankues "Aritech" sh.p.k, kërkon nga Organi Shqyrtues i prokurimit të marr masa ndaj Zyrtarit të prokurimit për mos zbatim të nenit 30.4 të Rregullores për Prokurimin Publik, siç klasifikohet si shkelje e rend sipas nenit 97 të kësaj rregulloreje. OE ankues potencon se rregullorja është e qartë dhe nuk i lenë OE-ve në mënyrë vullnetare të zgjasin apo jo validitetin

dhe sigurimin e tenderit.

Ekspertja shqyrtuese bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimi, shkresat e lëndës, pretendimet e ankuesit, dokumentet në platformën e-prokurimit, vendimin ndaj kërkesës për rishqyrtim të OE ankues të datës 30.11.2023, si dhe vazhdimin e validitetit dhe sigurimin e ofertës nga operatori ekonomik "Botek" shpk, vlerëson se ky aktivitet i prokurimit si proces nuk është proceduar konform afateve ligjore të LPP-së dhe Rregullores Nr. 001/2022, ku si pasojë e neglizhencës dhe papërgjegjësisë së autoritetit kontraktues, pësojnë operatorët ekonomik pjesëmarrës të cilët kanë shprehur interesim për këtë aktivitet të prokurimit.

Po ashtu, duke ju referuar edhe interpretimit të KRPP-së që është organ rregullativ dhe i vetmi i cili bënë interpretimin e dispozitave të LPP-së, si dhe interpretimin për çdo dokument që nxirret nga KRPP, që në rastin konkret "Rregulloren nr.001/2022 për Prokurimit Publik" është dokument i nxjerr nga KRPP, **ekspertja sqaron** se tek interpretimi me nr. 7 i datës 22.11.2022 është dhënë sqarimi si më poshtë:

Neni 30.3 i Rregullores për Prokurimin Publik, përcakton: "30.3 Periudha e validitetit të tenderit e specifikuar në dosjen e tenderit do të ndryshoj varësisht nga kompleksiteti i prokurimit. periudha e kërkuar e validitetit do të jetë jo më shumë se që është e nevojshme, dhe do të jetë e mjaftueshme për AK të bëjë vlerësimin e tenderëve të pranuar dhe të bëjë dhënien dhe nënshkrimin e kontratës". Neni 30.4 i Rregullores për Prokurimin Publik, përcakton: "30.4 Në situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetin të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit dhe duhet të ngritet në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)" "30.5 Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët do të kërkohet që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre". Sipas nenit 30.4 të lartcekur, nuk përcaktohet sa ditë para skadimit të validitetit të ofertave mund të kërkohet zgjatja e afatit të validitetit të ofertave. Megjithatë, është e rëndësishme që të ketë kontinuitet midis afatit të skaduar dhe atij të ri, për këtë arsye në këtë dispozitë thuhet: **"para datës së skadimit..**.." Pavarësisht se aktiviteti i prokurimit është në "Pezullim", AK në përputhje me nenin 30.4 të Rregullores për Prokurimin Publik duhet që të kërkojë zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Asnjë dispozitë e LPP-së dhe e legjislacionit dytësor, nuk përcakton përkufizimin e fjalës "Pezullim", megjithatë, KRPP konsideron se fjala "Pezullim" në kuptim të këtij ligji duhet të nënkuptojë mosndërmarrjen e ndonjë hapi në procedurat e prokurimit për derisa aktiviteti i prokurimit është i pezulluar. (Psh: hapja e tenderëve nuk duhet të bëhet nëse aktiviteti i prokurimit është pezulluar si rezultat i Kërkesës për rishqyrtim e parashtruar në AK, apo e një ankese e parashtruar në OSHP gjatë fazës së tenderimit, apo nënshkrimi i kontratës nuk duhet të bëhet për deri sa aktiviteti i prokurimit është në pezullim si rezultat i parashtrimit të një kërkese për rishqyrtim në AK, apo një ankese në OSHP) Neni

30.3 i Rregullores për Prokurimin Publik, **kërkon rreptësishtë që oferta të ketë validitet deri te dhënia dhe nënshkrimi i kontratës**. Prandaj KRPP konsideron se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës. **Për këtë arsye, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit duhet me kujdesin më të madh të përcjellë validitetin e ofertave, dhe në çdo rast duhet të kërkojë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohet zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit. KRPP do të monitorojë me kujdes të veçantë autoritetet kontraktuese për moszbatimin e nenit 30.4 të Rregullores për Prokurimin Publik. Mos zbatimi i nenit 30.4 klasifikohet si shkelje e rëndë sipas nenit 97 të kësaj rregulloreje, andaj KRPP do të ndërmarr masa në përputhje me nenin 97 të Rregullores për Prokurimin Publik.**

Ekspertja shqyrtuese sqaron se vazhdimi i validiteti dhe sigurimit të tenderit është bërë në mënyrë vullnetare nga operatori ekonomik "Botek" Sh.p.k, -Prishtinë, ku edhe ceket tek konfirmi për vazhdim të validitetit të ofertës ***"ne si OE <u>nuk kemi pranuar nga AK kërkesën</u> për vazhdim, mirëpo në mënyre qe të kemi ofertën tonë valide duke synuar të jemi ne harmoni me dispozitat ligjore ne mënyre vullnetare deklarojmë vazhdimin e vlefshmërisë se ofertës...".***

Ekspertja shqyrtuese vlerëson se autoriteti kontraktues Komuna e Podujevës nuk ka vepruar sipas nenit 30.4 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, ku kjo dispozitë ligjore e obligon shprehimisht zyrtarin përgjegjës të prokurimit që të kërkoj zgjatjen e afatit të validitetit të ofertave para skadimit të afatit. Në rastin konkret, validiteti i tenderëve dhe sigurimi i tenderit ka qenë për një periudhë prej 60 ditë (06.06.23-06-08-2023), ndërsa AK nuk ka ndërmarrë asnjë veprim deri me datë 25.10.2023, kur i është drejtuar operatorëve ekonomik me kërkesë për zgjatje të validitetit të ofertës dhe sigurimit të tenderit. Pra nga afati i fundit i validitetit të ofertave kanë kaluar afro 80 ditëve, që nënkupton me vonesë afro 80 ditë. Prej të gjithë OE pjesëmarrës, vetëm operatori ekonomik "Botek" Sh.p.k, (i rekomanduar) ka vazhduar validitetin dhe sigurimin e tenderit me vetë iniciativë, që do të thotë se shkelja procedurale është shkaktuar nga vet AK. Në aspektin ligjor dhe sipas interpretimit të KRPP-së, si dhe sipas nenit 30.3 të Rregullores për Prokurimin Publik, kërkohet që oferta të ketë validitet deri të dhënia dhe nënshkrimi i kontratës, ndërsa KRPP bazuar në interpretimin numër 7. 22.11.2022, konsideron se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës dhe për këtë arsye, KRPP e mban përgjegjës zyrtarin përgjegjës të prokurimit që të ketë kujdesin më të madh të përcjellë validitetin e ofertave, dhe në çdo rast

duhet të kërkojë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Po ashtu, në interpretimin e KRPP-së jepen sqarime se në **mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohet zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit sikurse në rastin konkret.**

Ekspertja shqyrtuesekonsideron se arsyetimi i AK-së se "kjo procedurë ka ngecë deri më tani në mungesë të mjeteve buxhetore" është arsyetim i paqëndrueshëm për shkak se AK me rastin e inicimit të aktivitetit të prokurimit duhet që në pajtueshmëri me nenin 9, par. 5 të LPP-së, duhet që të përdorë formularin standard B04 "Deklarata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmërisë së fondeve (DNPDF)" të përgatitur dhe miratuar nga KRPP për vlerësimin e nevojave dhe konstatimin e disponueshmërisë e fondeve, kurse aprovimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit do të konfirmohet me nënshkrim të DNPDF nga ZKA dhe ZKF. Për më tepër, edhe sikur të kishte mungesë të fondeve, kërkesa nga OE për zgjatje të validitetit të ofertave dhe sigurim të tenderit është kërkesë formale, e cila është përcaktuar në ligj dhe nuk mund të jepen arsyetime që në mungesë të fondeve të mos kryhet një veprim procedural, i përcaktuar në **nenin 30.4 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik,**ku kjo dispozitë ligjore e obligon shprehimisht zyrtarin përgjegjës të prokurimit që të kërkoj zgjatjen e afatit të validitetit të ofertave para skadimit të afatit.

Sa i përket ankesës së OE ankues, **ekspertja konsideron** se duhet të trajtohet si e bazuar për arsye se për shkak të gabimeve të autoritetit kontraktues, janë penalizuar operatorët ekonomik, sepse mos kërkesa e AK-së me kohë për zgjatje të validitetit të ofertës **nuk ka** ndodhur për shkak të veprimeve të operatorëve ekonomik por për shkak të vet neglizhencës së AK-së. Kjo neglizhencë e AK-së penalizon operatorët tjerë ekonomik të cilëve ju ka skaduar afati i validitetit.

Sa i përket kërkesës së OE ankues lidhur me nenin 97 të Rregullores Nr. 001/2022, ekspertja shqyrtuese sqaron se Autoritetit kontraktues është përgjegjës që të ndërmarr veprime në kuptime të nenit 30.4 dhe 30.5 të Rregullores Nr. 001/2022. Po ashtu mos zbatimi i nenit 30.4 klasifikohet si shkelje e rëndë sipas nenit 97.1 pika f) të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurim publik në të cilin thuhet: *"f. Mos zbatimi i nenit 30.4 të Rregullores së Prokurimit Publik nga zyrtari përgjegjës i prokurimit dhe si rrjedhojë skadimi të afateve kohore të*

vlefshmërisë dhe sigurisë së tenderëve". Andaj, kërkesa e OE ankues është e bazuar.

Sa i përket pretendimit të ankues, se rregullorja është e qartë dhe nuk i lenë OE-ve në mënyrë vullnetare të zgjasin validitetin dhe sigurimin e tenderit. **Ekspertja shqyrtues** sqaron ashtu siç u cek edhe me lartë neni 30.4 i Rregullores Nr. 001/2022 obligon zyrtarin përgjegjës të prokurimit që të kërkoj zgjatjen e afatit të validitetit të ofertave para skadimit të afatit, por nuk ndalon askund vazhdimin e vlefshmërisë dhe sigurisë së tenderit nga operatoret ekonomik.

<u>Provë:</u> Konfirmimet për vazhdim të validitetit të ofertës dhe sigurimi i tenderit nga operatori ekonomik "Botek" Sh.p.k , si dhe Kërkesa për zgjatjen te validitetit të ofertës dhe sigurimi te tenderit nga AK-Komuna e Podujevës e datës 25.10.2023.

BOTEK
IT ▪ Communication ▪ Security

Prishtinë, 10 Gusht 2023

Autoriteti kontraktues: Komuna e Podujevës
Titulli i tenderit: Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative

Numri i Prokurimit: 615-23-4097-5-5-8

Konfirmim për vazhdim të validitetit të ofertës

Bazuar në RrPP, neni 30, pika 30.4 – AK duhet të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. (Është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit).
Ne, si OE, nuk kemi pranuar nga AK kërkesën për vazhdimin e validitetit, mirëpo në mënyrë që të kemi ofertën tonë valide, duke synuar që të jemi në harmoni me dispozitat ligjore, ne në mënyrë vullnetare deklarojmë:
Përmes kësaj shkrese konfirmojmë vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës sonë edhe për 60 ditë kalendarike, nga data e skadimit të vlefshmërisë së ofertës (05.08.2023) për tenderin me titull: **Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative** dhe me numër të prokurimit: **615-23-4097-5-5-8.**

Oferta jonë do të jetë e vlefshme deri me datë: **04.10.2023.**

Gjithashtu konfirmojme edhe vazhdimin e sigurimit te tenderit, nga data e skadimit (05.08.2023) edhe për 60 ditë kalendarike. Sigurimi i tenderit do të jetë i vlefshëm deri me 04.10.2023.

BOTEK sh.p.k. IT Communication · Energy Systems Prishtinë, Republika e Kosovës

Hilmi Asllani
CEO | Botek LLC

Rr. Agim Ramadani, nr 517, objekti C, 10000 Prishtinë
Tel: +383 38 245 830 | +383 49 50 70 68| hilmi.asllani@bo-tek.com |

SIGURIA
DIMENSION I RI

Deklarata e garantuesit

SIGURIA E TENDERIT
POLICA NR. 060011350014100

Për: KOMUNA E PODUJEVËS
(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: BOTEK SH.P.K.
(në vazhdim "tenderuesi")

Titulli i prokurimit: Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative

Numri i Prokurimit: 615-23-4097-5-5-8

Garancion me kërkesë te pare

DERISA tenderuesi ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri tenderi duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE tenderuesi dëshiron të depozitojë garancinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;
DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci:

ANDAJ NE të poshtënënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të tenderuesit, deri në një total Gjasht mije Euro 6,000.00 € zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

a. Autoriteti kontraktues konstaton, në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht, se ai tenderues i ka dhënë informacione përmbajtësisht të gabueshme ose mashtruese autoritetit kontraktues;
b. Tenderuesi tërheq tenderin e tij pas skadimit të afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të përcaktuar në dosje të tenderit;
c. Tenderuesit i është dhënë kontrata në fjalë në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi refuzon apo dështon:
   * Që të depozitojë sigurinë e ekzekutimit të specifikuar në dosjen e tenderit;
   * Të plotësojë të gjitha kushtet që i paraprijnë nënshkrimit të kontratës në fjalë siç është përcaktuar në dosjen e tenderit; apo
   * Të lidhë kontratë që u përshtatet afateve dhe kushteve të saktësuara në dosjen e tenderit.

Pagesa në shumën e limituar prej 6.000,00 € siç është lartcekur, siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vërtetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu".

Kjo siguri vlen 60 dite

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit
Kompania e Sigurimeve "SIGURIA"
Emri i institucionit financiar

Adresa: Rr. Qamil Hoxha, nr.51, Prishtinë

Data: 05.08.2023

BOTEK
IT • Communication • Security

Prishtinë, 5 Tetor 2023

Autoriteti kontraktues: Komuna e Podujevës
Titulli i tenderit: Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative

Numri i Prokurimit: 615-23-4097-5-5-8

Konfirmim për vazhdim të validitetit të ofertës

Bazuar në RrPP, neni 30, pika 30.4 – AK duhet të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. (Është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit).
Ne, si OE, nuk kemi pranuar nga AK kërkesën për vazhdimin e validitetit, mirëpo në mënyrë që të kemi ofertën tonë valide, duke synuar që të jemi në harmoni me dispozitat ligjore, ne në mënyrë vullnetare deklarojmë:
Përmes kësaj shkrese konfirmojmë vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës sonë edhe për 60 ditë kalendarike, nga data e skadimit të vlefshmërisë së ofertës (04.10.2023) për tenderin me titull: **Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative** dhe me numër të prokurimit: **615-23-4097-5-5-8.**

Oferta jonë do të jetë e vlefshme deri me datë: **04.12.2023.**

Gjithashtu konfirmojmë edhe vazhdimin e sigurimit të tenderit, nga data e skadimit (04.10.2023) edhe për 60 ditë kalendarike. Sigurimi i tenderit do të jetë i vlefshëm deri më 04.12.2023.

IT Communication • Energy • BOTEK sh.p.k. • Prishtinë, Republika e Kosovës

Hilmi Asllani
CEO | Botek LLC

Rr. Agim Ramadani, nr.517, objekti G, 10000 Prishtinë

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

Mbrojmë atë që ka vlerë!

SIGURIA E TENDERIT

POLICA NR. BND0016587

[redacted]

Per: KOMUNA E PODUJEVES
(ne vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Ne emer te: BOTEK SH.P.K me seli qendrore ne adresen AGIM RAMADANI AKTSH I OBJ C, PRISHTINE
(ne vazhdim: "tenderuesi")

Titulli i aktivitetit te prokurimit: Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative

Numri i Prokurimit: 615-23-4097-5-5-8

Numri i brendshem:

Garancion me kerkese te pare

DERISA tenderuesi ka ndermarre veprimet per te dorezuar nje siguri tenderi duke iu referuar Dosjes se Tenderit, me numer te prokurimit te lartcekur te derguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE tenderuesi deshiron te depozitoje garancine ne shumen e saktesuar ne Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim tenderuesit kete garanci:

ANDAJ NE, me kete konfirmojme se jemi Garantues dhe pergjegjes para jush, ne emer te tenderuesit, deri ne nje total prej: **6,000.00 gjashte mij Euro** zotohemi te ju paguajme, qe me kerkesen tuaj te pare me shkrim ne te cilen deklarohet mospermbushja e njerit nga kushtet ne vijim:

a.Autoriteti kontraktues konstaton,ne baze te deshmive te vertetueshme objektivisht, se ai tenderues i ka dhene informacione permbajtesish te gabueshme ose mashtruese Autoritetit Kontraktues;

b.Tenderuese terheq tenderin e tij pas skadimit te afatit te fundit per dorezim te tendereve, por para skadimit te perfundhes se vlefshmerise se tenderit te percaktuar ne Dosjeje te Tenderit;

c.Tenderuesit i eshte dhene kontrata ne fjale ne baze te tenderit te tij dhe tenderuesi refuzon apo deshton:
o Qe te depozitoje sigurine e ekzekutimit te specifikuar ne Dosjen e Tenderit;
oTe plotesoje te gjitha kushtet qe i paraprijne nenshkrimit te kontrates ne fjale sic eshte percaktuar ne Dosjen e Tenderit; apo
oTe lidhe kontrate qe u pershtatet afateve dhe kushteve te saktesuara ne dosjen e tenderit.

Pagesa ne shumen e limituar prej **6,000.00 gjashte mij Euro** sic eshte lartcekur, pa pasur nevoje te vertetoni apo te tregoni arsyet ose shkaqet e kerkeses tuaj, apo per shumen e specifikuar ketu.

Kjo siguri vlen **60 dite** nga dita e hapjes

Nenshkrimi dhe vula e Garantuesit

SIGMA
SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË - DIREKTORIA E SHITJES

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË
AKTASH RRUGA EDMOND HOXHA NR.27 10000 PRISHTINË, REPUBLIKA E KOSOVËS
DATA E FILLIMIT: 06.06.2023

ILLYRIA
KOMPANIA E SIGURIMEVE

Polica NR. OP-00332117

Shitësi:	Ardonis Hajdari, S530
Lloji i Renovimit:	E re

Kontraktuesi

Emri	BOTEK SH.P.K.
Nr.Fiskal	810356081
Adresa	Rr. Agim Ramadani - Aktash I Obj. C p/n, 10000 Prishtine, Republic of Kosova

Periudha e sigurimit	05.10.2023 24:00	04.12.2023 24:00
Periudha e llogaritjes	05.10.2023	04.12.2023

Lënda: Garancioni i ofertës : Autoriteti kontraktues: Komuna e Podujevës
Titulli: Furnizim me pajisje të Teknologjisë informative
Numri i prokurimit: 615-23-4097-5-5-8

BD0101 - Garancionet e Ofertës Fikse

I SIGURUARI

BOTEK SH.P.K., 810356081 Adresa: Rr. Agim Ramadani - Aktash I Obj. C p/n, 10000 Prishtine

I siguruari nuk mund ta ndërpresë kontratën e sigurimit po që se gjatë periudhës siguruese është kompensuar ndonjë kërkesë

Shuma e siguruar

Mënyra e sigurimit	Vlera
Limiti i mbulimit	6.000

LLOGARITJA

Gjithsej	60,55

Nëse kontraktuesi/personi i siguruar nuk e paguan preminë për sigurim në afatin e përcaktuar, atëherë do të zbatohet ndërprerja e kontratës konform ligjit mbi detyrimet.

Siguruesi e ruan të drejtën që gabimet eventuale në llogaritje dhe gabimet tjera teknike në policë ti përmirësoj ne momentin e evidentimit.

Të gjitha të drejtat sipas kësaj police i takojnë personit të siguruar.

Mënyra e pagesës

Mënyra e pagesës	Në total pas dorëzimit të faturës
Premia bazë	60,55
TVSH	10,90
Gjithsej primi	71,45

Mjeti i pageses

Letër krediti	71,45
Gjithsej	71,45

Në cilësin e të siguruarit, deklarol se i kam lexuar, i kam kuptuar, si dhe i pranoi të gjitha kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kësaj police.

BOTEK
IT ▪ Communication ▪ Security

Prishtinë, 25 Tetor 2023

Autoriteti kontraktues: Komuna e Podujevës
Titulli i tenderit: Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative

Numri i Prokurimit: 6'5-23-4097-5-5-8

Konfirmim për vazhdim të validitetit të ofertës

Përmes kësaj shkrese konfirmojmë vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës sonë edhe për 30 ditë kalendarike, nga data e skadimit të vlefshmërisë së ofertës (04.12.2023) për tenderin me titull: **Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative** dhe me numër të prokurimit: **615-23-4097-5-5-8**.

Oferta jonë do të jetë e vlefshme deri me datë: **03.01.2024.**

BOTEK sh.p.k. IT Communication - Energji 2002 Prishtinë, Republika e Kosovës 2015

Hilmi Asllani
CEO | Botek LLC

Rr. Agim Ramadani, nr 517, objekti C, 10000 Prishtinë
Tel: +383 38 245 830 | +383 49 50 70 68| hilmi.asllani@bo-tek.com |

ILLYRIA
KOMPANIA E SIGURIMEVE

Polica NR. OP-00336592

Shitësi:	Ardonis Hajdari, S530
Llojl i Renovimit:	E re

Kontraktuesi

Emri	BOTEK SH.P.K.
Nr.Fiskal	810356081
Adresa	Rr. Agim Ramadani - Aktash I Obj. C p/n, 10000 Prishtine, Republic of Kosova

Periudha e sigurimit	05.12.2023 24:00	05.02.2024 24:00
Periudha e llogaritjes	05.12.2023	05.02.2024

Lënda: Garancioni i ofertës : Autoriteti kontraktues: Komuna e Podujevës
Titulli: Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative
Numri i prokurimit:615-23-4097-5-5-8

Vazhdim i sigurimit polica me numer OP-00332117.

BD0101 - Garancionet e Ofertës Fikse

I SIGURUARI

BOTEK SH.P.K., 810356081 Adresa: Rr. Agim Ramadani - Aktash I Obj. C p/n, 10000 Prishtine

I siguruari nuk mund ta ndërpresë kontratën e sigurimit po që se gjatë periudhës siguruese është kompensuar ndonjë kërkesë

Shuma e siguruar

	Mënyra e sigurimit	Vlera
Limiti i mbulimit		6.000

LLOGARITJA

Gjithsej	60,55

Nëse kontraktuesi/personi i siguruar nuk e paguan preminë për sigurim në afatin e përcaktuar, atëherë do të zbatohet ndërprerja e kontratës konform ligjit mbi detyrimet.
Siguruesi e ruan të drejtën që gabimet eventuale në llogaritje dhe gabimet tjera teknike në policë ti përmirësoj ne momentin e evidentimit.
Të gjitha të drejtat sipas kësaj police i takojnë personit të siguruar.

Mënyra e pagesës

Mënyra e pagesës	Në total pas dorëzimit të faturës
Premia bazë	60,55
TVSH	10,90
Gjithsej primi	71,45

Mjeti i pagesës

Letër krediti	71,45
Gjithsej	71,45

Në cilësin e të siguruarit, deklarol se i kam lexuar, i kam kuptuar, si dhe i pranoi të gjitha kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kësaj police.

Polica: OP-00336592

Data e lëshimit: 5.12.2023, 8:57:42

Kompania e Sigurimeve "ILLYRIA" Prishtinë. Adresa: Sheshi "Nëna Terezë", nr.33

From: prokurimi podujeva <prokurimi.podujeva@rks-gov.net>
Sent: Wednesday, October 25, 2023 2:35 PM
To: diti@ilir-ks.com; edona@interadria-ks.com; arbnora@aritech-ks.com; zymber.zugaku@storm-ict.com; hilmi.asllani@bo-tek.com; leonida.ternava@bo-tek.com; office@bo-tek.com
Subject: Kërkesë për zgjatjen e afatit te vlefshmërise dhe sigurise së tenderit

Të nderuar,

Ju jeni pjesëmarrës në tenderin me nr 615234097558

Kjo procedurë ka ngec deri më tani në mungesë të mjeteve buxhetore.

Tani AK ka siguruar mjetet dhe ne mund të vazhdojmë me publikimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK

Para se të bëhet ky Njoftim, ju lutemi që te na ofroni nje deklarate per zgjatjen e vlefshmerise se tenderit si dhe ta beni vazhdimin e siguris se tenderit

Vlefshmeria e tenderit te zgjatet per 60 dite ndersa siguria e tenderit per 30 dite

Dokumentet të sillen jo me larg se deri me date 27.10.2023

Ne rast te deshtimit te dokumentacionit deri ne afatin e caktuar, ne konsiderojme se ju keni heq dore nga ky projekt.

Me respekt!

Zyra e prokurimit, Podujeve

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertit shqyrtues i propozon paneli shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar për arsyet të cilat u sqaruan në ketë raport, ndërsa autoriteti kontraktues të vazhdoj tutje /ta mbajt në fuqi njoftimin e datës 23.11.2023.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar për arsye të cilat u sqarun si më lartë, ndërsa AK të vazhdojë tutje me aktivitetin e prokurimit.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PODUJEVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **ARITECH**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Majlinda Bedrolli